

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar i Avancuar

P9

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 27.9.2025

1.

a) Grupi Rose është një kompani përpunimi metali të rendë që furnizon tregjet vendase ashtu edhe për ato të huaja. Rose sh.a ka 3 filiale, përkatësisht Gillan sh.a, Tate sh.a dhe Bach sh.a dhe një ortakëri Cavalera sh.a, të cilat i bleu disa vite më parë. Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes së grupit për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024 dhe pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare në atë datë janë paraqitur më poshtë:

**Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes për vitin që përfundoi më 31 dhjetor
(ekstrakt)**

	2024	2023
	€	€
Fitimi nga operacionet	651,150	640,496
Anulim (humbje) nga dëmtimi	2,500	(1,250)
Kosto financiare	(52,000)	(40,825)
Pjesa e fitimit të ortakërisë	<u>127,575</u>	<u>108,439</u>
Fitimi para tatimit	729,225	706,860
Shpenzimet e tatimit në fitim	<u>(145,800)</u>	<u>(123,930)</u>
Fitimi për vitin (operacione të vazhdueshme)	583,425	582,930
Fitimi për vitin (operacione të ndërprera)	<u>102,375</u>	<u>-</u>
Fitimi për vitin	685,800	582,930
I atribuohet:		
Pronarët e Rose sh.a	571,725	485,966
Interesave jo-kontrollues	<u>114,075</u>	<u>96,964</u>
	685,800	582,930

Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare më 31 dhjetor

	2024	2023
	€	€
Pasuritë		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, impiantet dhe pajisjet	2,283,350	2,212,875
Pasuritë e patrupëzuara	22,000	-
Investimet në ortakëri	<u>418,275</u>	<u>404,550</u>
	2,723,625	2,617,425
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	170,325	200,025
Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e tyre	<u>46,125</u>	<u>32,625</u>
	<u>216,450</u>	<u>232,650</u>
Total pasuritë	2,940,075	2,850,075
Ekuiteti dhe detyrimet		
<i>Ekuiteti</i>		
Aksionet e zakonshme (€0.50 secila)	495,000	315,000
Premia e aksioneve	112,500	45,000
Fitimet e mbajtura	<u>1,491,750</u>	<u>1,518,975</u>
	2,099,250	1,878,975
Interesat jo-kontrollues	<u>315,450</u>	<u>339,300</u>
	2,414,700	2,218,275

<i>Detyrimet afatgjata</i>		
Detyrimet ndaj lizingut	239,100	300,000
Detyrimet për përfitimet e punonjësve	<u>42,150</u>	<u>37,500</u>
	281,250	337,500
<i>Detyrimet afatshkurta</i>		
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	90,000	118,800
Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura	1,125	-
Tatimi mbi të ardhurat i pagueshëm	<u>153,000</u>	<u>175,500</u>
	244,125	294,300
Total ekuiteti dhe detyrimet	2,940,075	2,850,075

Informata shtesë:

- i) Rose zotëron 60% të aksioneve në Tate sh.a. Zëri i mirë që i atribuohet Rose sh.a i përfutur nga kombinimi i biznesit ishte €67,500. Vlera kontabël e pasurive neto të identifikueshme të Tate sh.a (duke përjashtuar zërin e mirë të përfutur nga kombinimi i biznesit) në pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit është €180,000 më 31 dhjetor 2024. Shuma e rikuperueshme e Tate sh.a pritet të jetë €230,000 dhe nuk është regjistruar asnjë humbje nga dëmtimi deri më 31 dhjetor 2023.
- ii) Rose sh.a shiti të gjitha 75% të aksioneve të saj në Gillan sh.a për para të gatshme gjatë vitit që përfundoi më 31 dhjetor 2024. Më 31 dhjetor 2023, i gjithë zëri i mirë i fituar në kombinimin e biznesit me Gillan sh.a ishte shlyer. Fitimi nga operacionet e ndërprera në pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes më sipër lidhet tërësisht me shitjen e aksioneve në Gillan sh.a dhe mund të analizohet si më poshtë:

	€
Fitimi para tatimit	93,150
Shpenzimet e tatimit në fitim	(14,400)
Fitimi nga shitja	<u>23,625</u>
	102,375

Pasuritë neto të Gillan sh.a në datën e shitjes ishin si më poshtë::

	€
Prona, impiantet dhe pajisjet	421,875
Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	31,275
Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e tyre	3,375
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	<u>(19,012)</u>
	437,513

- iii) Më 31 mars 2024, Rose sh.a emetoi 100,000 aksione të zakonshme për para të gatshme. Kjo u pasua nga një emetim bonus më 30 shtator 2024, duke përdorur llogarinë e premisë së aksioneve. Të gjitha kompanitë e grupit paguan dividendë të zakonshëm gjatë vitit.
- iv) Një zhvlerësim prej €395,100 u njoh gjatë vitit që përfundoi më 31 dhjetor 2024. Përveç pronës, impianteve dhe pajisjeve të shitura nëpërmjet shitjes së Gillan sh.a, një impiant me një vlerë kontabël prej €126,000 u shit për para të gatshme prej €135,000.

- v) Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera përfshijnë €11,250 (2023: €6,750) interes të papaguar për kredinë bankare.

Kërkohe:

Përgatitni një pasqyrë të konsoliduar të rrjedhave të parave të gatshme për grupin Rose për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024, duke përfshirë një shënim që rikonsilon fitimin para tatimit me paratë e gjeneruara nga operacionet, duke përdorur metodën indirekte. (Një shënim që tregon efektet e shitjes së Gillan sh.a nuk kërkohe). (20 pikë)

b) Për qëllime konsolidimi, një kompani prind mëmë duhet të konsolidojë të gjitha entitete e kontrolluara. Megjithatë, ekziston një përjashtim që zbatohet për entitetet e investimeve. Para prezantimit të udhëzimeve specifike për entitetet e investimeve të nevojshme për të aplikuar SNRF 10 *Pasqyrat financiare të konsoliduara* investitorët dhe përdoruesit e tjerë të pasqyrave janë ndier se kjo nuk ka rezultuar në informata të dobishme dhe se informatat më të dobishme dhe më relevante do të ishin njohja e investimeve me vlerën e drejtë.

Si rezultat, që nga viti 2012, SNRF 10 *Pasqyrat financiare të konsoliduara* ka përfshirë një kërkesë që entitetet e investimeve të masin filialet me vlerë e drejtë përmes fitimit ose humbjes në vend se t'i konsolidojnë ato.

Kjo kërkesë aplikohet vetëm për filialet e një entiteti investiv i cili nuk ofron shërbimet të cilat lidhen me aktivitetet e entitetit investiv. Filialet të cilat ofrojnë shërbime të lidhura me investimet janë konsoliduar si normale.

Në janar të vitit 2015, ndryshimet në SNRF 10 qartësojnë më tej aplikimin e përjashtimeve të entitetit investiv

Kërkohe:

Shpjegoni karakteristikat e një entiteti të investimit dhe aplikimin e përjashtimeve të konsolidimit të entitetit investiv. (5 pikë)

(Total: 25 pikë)

1.

Grupi Rose

Pasqyra e konsoliduar e rrjedhave të parave për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024

€

Rrjedhjet e parasë së gatshme prej aktiviteteve operacionale

Paraja e gjeneruar nga operacionet (shënim)	1,082,812
Dëmtimi në Tate sh.a (L17)	37,500
Aulimi i dëmtimit	2,500
Interesi i paguar (L11)	(47,500)
Tatimi në fitim i paguar (L12)	<u>(182,700)</u>
Neto rrjedhjet e parasë së gatshme prej aktiviteteve operacionale	892,612

Rrjedhjet e parasë së gatshme prej aktiviteteve të investimit

Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve (L13)	(1,013,450)
Blerja e pasurive të patrupëzuara	(22,000)
Arkëtimet nga shitja e pronës, impiantit dhe pajisjeve	135,000
Dividendët e arkëtuara nga ortakëria (L14)	113,850
Shitja e Gillan sh.a neto nga paraja ((437,513 x 75%) + 23,625) - 3,375)	<u>348,385</u>
Neto daljet e parasë së gatshme prej aktiviteteve të investimit	(438,215)

Rrjedhjet e parasë së gatshme nga aktivitetet e financimit

Arkëtimet nga emetimet e aksioneve (495,000 + 112,500) - 315,000 + 45,000)	247,500
Pagesa e detyrimeve të lizingut (300,000 - 239,100)	(60,900)
Dividenda e paguar (L15)	(598,950)
Dividenda e paguar për interesat jo-kontrollues (L16)	<u>(28,547)</u>
Neto daljet e parasë së gatshme prej aktiviteteve të financimit	(440,897)

Rritja neto e parave të gatshme dhe ekuivalentëve të tyre gjatë vitit	13,500
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	<u>32,625</u>
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	46,125

Shënim: rikonsilimi i fitimit para tatimit me paratë e gjeneruara nga operacionet

Fitimi para tatimit (729,225 + 93,150)	822,375
Anulimi i dëmtimit	(2,500)
Dëmtimi në Tate sh.a (L17)	(37,500)
Pjesa e fitimit të ortakërisë	(127,575)
Kosto financiare	52,000
Fitimi nga shitja e pronës, impianteve dhe pajisjeve (135,000 - 126,000)	(9,000)
Ngarkimi i zhvlerësimit	395,100
Rritja në të arkëtueshme tregtare dhe të tjera ((170,325 + 31,275) - 200,025)	(1,575)
Detyrimet për përfitimet e punonjësve (42,150 - 37,500)	4,650
Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura	1,125
Zvogëlimi në të pagueshmet tregtare ((118,800 - 6,750) - (90,000 + 19,012 - 11,250))	<u>(14,288)</u>
Paraja e gjeneruar nga operacionet	1,082,812

Llogaritjet

LI.1 Interesi i paguar

Paraja s/b	47,500	Në fillim	6,750
Në fund	<u>11,250</u>	PFH	<u>52,000</u>
	58,750		58,750

LI.2 Tatimi në fitim

Paraja s/b	182,700	Në fillim	175,500
Në fund	<u>153,000</u>	PFH (145,800+14,400)	<u>160,200</u>
	335,700		335,700

LI.3 Prona, impiantet dhe paisjet

Në fillim	2,212,875	Shitja e ortakërisë	421,875
		Shitjet tjera	126,000
		Zhvlerësimi i ngarkuar	395,100
Shtesat s/b	<u>1,013,450</u>	Në fund	<u>2,283,350</u>
	3,226,325		3,226,325

LI.4 Investimi në ortakëri

Në fillim	404,550	Paraja e pranuar s/b	175,500
PFH	<u>127,575</u>	Në fund	<u>418,275</u>
	532,125		532,125

LI.5 Fitimet e mbajtura

Dividenda në PNE s/b	598,950	Në fillim	1,518,975
Në fund	<u>1,491,750</u>	PFH	<u>571,725</u>
	2,090,700		2,090,700

LI.6 Interesi jo-kontrollues

Paraja s/b	28,547	Në fillim	339,300
Shitja (437,512 x 25%)	109,378	PFH	<u>114,075</u>
Në fund	<u>315,450</u>	PFH	<u>114,075</u>
	453,375		453,375

LI.7 Dëmtimi i zërit të mirë - Tate sh.a

	Zëri i mirë	Neto pasuritë	Total
	€	€	€
Shuma bartëse	67,500	180,000	247,500
Interes jo-kontrollues i panjohur (67,500 x 40 / 60)	<u>45,000</u>	-	<u>45,000</u>
	112,500	180,000	292,500
Shuma e rikuperueshme			230,000
Humbja nga dëmtimi = 292,500 - 230,000 =			62,500
Zëri i mirë do të zvogëlohet me 60% e 62,500 pra 37,500.			
Fitimi ose humbja do të ngarkohet me 37,500			

b) Një entitet i investimit përkufizohet si një entitet i cili:

- Siguron fondet nga një ose më shumë investitorë për qëllime të ofrimit të këtyre investitorëve me shërbimeve e menaxhimit të investimeve
- Përkushtohet ndaj investitorëve të saj se qëllimi i tij afarist është të investojë fondet vetëm për kthimet nga vlerësimi kapital, të ardhurat nga investimet dhe të dyja, dhe
- Mat dhe vlerëson performancën e të gjitha investimeve në baza të vlerës së drejtë

Entitetet dhe investimet përfshijnë organizata, organizatat e kapitalit sipërmarrës, fondet pensioneale dhe fondet e tjera investive.

Përrjashtimi nga përrgatitja pasqyrave të konsoliduara financiare është ende në dispozicion për një kompani amë edhe në rastet kur kompania fundit (ose e ndërrmjetme) amë është një entitet investiv dhe mat të gjitha filialet e saj me vlerë e drejtë në vend të prodhimit të pasqyrave të konsoliduara financiare.

Kërkesa për konsolidim si normale një filial që ofron shërbime për një entitet investiv aplikohet vetëm në rastet kur:

- Vetë filiali nuk është një entitet investiv, dhe
- Qëllimi kryesor i filialit është ofrimi i shërbimeve dhe aktiviteteve që janë të lidhura me aktivitetet e investimit të entitetit amë.

2.

a) Dio sh.a është një distributor i madh i veturave në Kosovë. Dio sh.a aktualisht po përgatit pasqyrat e saj financiare për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024. Dio sh.a shet vetura në tre zona të ndryshme në të gjithë Kosovën. Në datën e raportimit, Dio sh.a ka një flotë prej 300 veturave (të të njëjtit lloj, model dhe vjetërsi) për të cilat drejtorët e Dio sh.a do të donin të vlerësonin vlerën e tyre të drejtë.

Kryetari i bordit beson se vlera e drejtë duhet të bazohet në të dhënat nga tregu i cili ofron përfitimet më të larta neto nga shitjet e veturave. Informacioni rreth të tre tregjeve është si më poshtë:

	Total vëllimi i tregut	Vëllimi i shitjeve të veturave për Dio sh.a (njësi)	Çmimi shitës €	Kosto e transportit €	Kosto e transaksionit €
Zona veriore	6,500	960	27,000	2,000	1,500
Zona jugore	9,800	608	28,000	3,100	1,900
Zona perendimore	5,000	800	25,000	2,500	2,500
Total	21,300	2,368			

Kërkohe:

Në përputhje me SNRF 13 *Matja e vlerës së drejtë*, shpjegoni me llogaritje se me çfarë vlerë të drejtë duhet të vlerësohet totali i 300 veturave më 31 dhjetor 2024 dhe komentoni mbi saktësinë e mendimit të kryetarit të bordit. (5 pikë)

b) Një kompani farmaceutike, Vedder sh.a., po zhvillon aktualisht një ilaç që do të përdoret në trajtimin e një sëmundjeje shumë specifike që prek një grup të vogël pacientësh.

Menaxhmenti ka vendosur ta zhvilloj këtë ilaç për arsye reputacioni. Vedder sh.a. ka prezantuar një mekanizëm inovativ çmimesh për këtë ilaç, sipas të cilit një pacient do të paguajë vetëm nëse ilaçi provohet të jetë efektiv. Vedder sh.a. ka marrë miratimin rregullator nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale dhe beson se të gjitha kriteret e tjera të kapitalizimit në SNK 38 *Pasuritë e paprekshme* janë përmbushur, përveç shqetësimeve në lidhje me potencialin e tij në treg.

Në një situatë tjetër, Vedder sh.a. ka përcaktuar se ka përmbushur kriteret e kapitalizimit për një pajisje për administrimin e vaksinës. Po vazhdon shpenzimet për pajisjen për të shtuar funksionalitete të reja.

Zhvillimi i kësaj pajisjeje do të kërkojë miratim të ri rregullator.

Kërkohe:

Në përputhje me SNK 38 *Pasuritë e paprekshme*, shpjegoni se si Vedder sh.a duhet të kontabilizoj koston e zhvillimit të ilaçit për përdorimin e kufizuar të tregut dhe shpenzimet e zhvillimit për funksionalitetin e ri të pajisjeve. (5 pikë)

c) Staley sh.a bleu një pasuri jo-qarkulluese më 1 janar 2020 me një kosto prej €60,000. Në atë datë, pasuria kishte një jetëgjatësi të dobishme të vlerësuar prej dhjetë vjetësh dhe vlerë të mbetur në fund të jetës se dobishme të vlerësuar prej €0. Staley sh.a nuk e rivlerëson këtë lloj pasurie, por e kontabilizon atë në bazë të kostos historike të zhvlerësuar duke përdorur metoden lineare. Më 31 dhjetor 2021, pasuria i nënshtrohet një shqyrtimi të dëmtimit dhe kishte një shumë të rikuperueshme prej €32,000. Më 31 dhjetor 2024, rrethanat që shkaktuan njohjen e dëmtimit fillestar nuk ekzistojnë më dhe nuk janë më të zbatueshme, me rezultatin që shuma e rikuperueshme tani është €80,000.

Kërkohet:

Këshilloni trajtimin e duhur kontabël të transaksionit të mësipërm nga Staley sh.a për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024. (5 pikë)

[Total: 15 pikë]

2.

a) SNRF 13 *Matja e vlerës së drejtë* përcakton se, kur matet vlera e drejtë, objektivi është të vlerësohet çmimi me të cilin do të zhvillohej një transaksion i rregullt për të shitur një pasuri ose për të transferuar një detyrim midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në kushtet aktuale të tregut (domethënë, të vlerësohet një çmim daljeje).

Një matje e vlerës së drejtë supozon se transaksioni për të shitur pasurinë apo transferuar detyrimin ndodh:

- Në tregun kryesor për pasurinë apo detyrimin; ose
- Në mungesë të një tregu kryesor, në tregun më të avancuar për pasurinë dhe detyrimin.

Vetëm në mungesë të një tregu kryesor, entiteti supozon se transaksioni zhvillohet në tregun më të favorshëm (tregu që maksimizon shumën që do të merrej për të shitur pasurinë ose minimizon shumën që do të paguhej për të transferuar detyrimin, pasi të merren parasysh kostot e transaksionit dhe kostot e transportit).

Prandaj, Dio sh.a duhet ta bazojë matjen e vlerës së drejtë në çmimet në zonën jugore. Çmimi merret nga ky treg edhe pse Dio sh.a normalisht nuk kryen transaksione në atë treg dhe nuk është tregu më i favorshëm.

Prandaj, vlera e drejtë për veturë është €24,900 (€28,000 - €3,100), duke marrë parasysh kostot e transportit, por jo koston e transaksionit, edhe pse Dio sh.a ushtron biznes kryesisht në zonën veriore dhe mund të maksimizojë të ardhurat e saj neto në atë treg (€27,000 - €3,500 = €23,500).

Më 31 dhjetor 2024, vlera totale e të gjitha 300 veturave duhet të matet në €7.47 milionë (€24,900 x 300).

Dio sh.a do të lejohej të përdorte të dhëna me vlerë të drejtë nga zona veriore, e cila përfaqëson tregun më të favorshëm, vetëm nëse dhe vetëm nëse kompania nuk është në gjendje të hyjë në tregun kryesor (domethënë, zonën Jugore).

Në këtë rast, vlera e drejtë për veturë do të ishte €25,000 (€27,000 - €2,000).

b) Një pasuri e paprekshme nga një aktivitet zhvillimi duhet të njihet vetëm nëse është e mundshme që përfitimet e pritura ekonomike në të ardhmen që i atribuohen pasurisë do të rrjedhin në entitet dhe kostoja e pasurisë mund të matet me besueshmëri.

Kostot e zhvillimit mund të kontabilizohen si pasuri të patrupëzuara në rast se entiteti është i aftë të demonstrojë përmbushjen e plotë të kriterëve të mëposhtme.

- Fizibilitetin teknik [realizueshmërinë teknike] të përfundimit të pasurive të patrupëzuara në mënyrë që ato të bëhen të gatshme për t'u përdorur ose për t'u shitur.
- Synimin e entitetit për të përfunduar pasuritë e patrupëzuara dhe për t'i përdorurose shitur ato.
- Aftësinë për të përdorur ose shitur pasuritë e patrupëzuara.
- Mënyrën se si pasuritë e patrupëzuara do të gjenerojnë përfitime të mundshmetë ardhshme ekonomike. Midis gjërave të tjera, entiteti duhet të demonstrojë ekzistencën e një tregu për mallrat ose shërbimet që prodhojnë vetë pasuritë e patrupëzuara ose,

nëse ato do të jenë për përdorim të brendshëm, dobishmërinë e pasurive të patrupëzuara.

- Aftësinë për të matur në mënyrë të besueshme shpenzimet të cilat mund t'i ngarkohen këtyre pasurive të patrupëzuara gjatë zhvillimit të tyre.

Kostoja e zhvillimit për përdorim të kufizuar në treg

Të gjitha kriteret e zhvillimit duhet të përmbushen për të filluar kapitalizimin e kostove të zhvillimit. Një tregues i fortë se një njësi i ka përmbushur të gjitha kriteret e mësipërme është kur ajo merr miratimin përfundimtar nga autoritet rregullator. Vedder sh.a duhet të kapitalizojë kostot e zhvillimit për këtë ilaç kur përmbushen kriteret në SNK 38 *Pasuritë e paprekshme*, kjo ka të ngjarë të ndodhë në miratimin nga autoritet rregullator.

Vedder sh.a do të duhet të vlerësojë kostot e kapitalizuara për çdo tregues të dëmtimit në çdo datë raportimi dhe t'i testojë për dëmtim çdo vit para se të jetë në dispozicion për përdorim.

Shqetësimi për tregun potencial mund të jetë një tregues për dëmtim.

Shpenzimet e zhvillimit të funksionalitetit të ri

Vedder sh.a nuk duhet të kapitalizojë shpenzimet që bën për të shtuar funksionalitet të ri, sepse funksionaliteti i ri do të kërkojë aplikimin për miratim të ri rregullator. Kjo kërkesë nënkupton që fizibiliteti teknik i pajisjes së modifikuar nuk është arritur.

c) Një pasuri ose një njësi gjeneruese parash është e dëmtuar nëse shuma e saj e rikuperueshme është nën vlerën që shfaqet aktualisht në pasqyrën e pozitës financiare, vlerën aktuale kontabël të pasurisë. Shuma e rikuperueshme e një pasurie duhet të matet me anë të njëjës prej vlerave të mëposhtme, cilado qoftë më e larta:

- Vlera e drejtë e pasurisë minus kostot për ta shitur atë; dhe
- Vlera e përdorimit.

Vlera në përdorim e një pasurie matet si vlera e tanishme e rrjedhjeve të parasë e gatshme që vlerësohet se do të gjenerohen në të ardhmen (hyrjet minus daljet) prej pasurisë, përfshirë këtu vlerën neto të vlerësuar të shitjes [largimit] (nëse ka) në fund të jetës së vet të dobishme e të pritshme.. Objektivi është të vendosen rregulla për të siguruar që pasuritë e një entiteti të mbahen në jo më shumë se shuma e tyre e rikuperueshme.

Viti që përfundoi më 31 dhjetor 2021	€
Kostoja e pasurive më 1 janar 2020	60,000
Zhvlerësimi deri më 31 dhjetor 2021 ($60,000 \times 2/10$)	<u>(12,000)</u>
Vlera bartëse më 31 dhjetor 2021	48,000
Shuma e rikuperueshme	<u>(32,000)</u>
Humbja nga dëmtimi	16,000

Pasuria është ulur në vlerë në €32,000 dhe humbja nga rënia në vlerë prej €16,000 ngarkohet në fitim ose humbje. Shpenzimi i zhvlerësimit në vit në periudhat e ardhshme do të jetë €4,000 ($€32,000 \times 1/8$).

Viti që përfundoi më 31 dhjetor 2024	€
Kostoja e pasurive më 1 janar 2022	32,000
Zhvlerësimi deri më 31 dhjetor 2024 (3/8)	<u>(12,000)</u>
Shuma e bartur me 31 dhjetor 2024	20,000
Shuma e rikuperueshme	80,000
Humbja nga dëmtimi = 0	

Nuk ka pasur humbje nga dëmtimi. Në fakt, ka pasur një anulim të plotë të humbjes së parë nga dëmtimi. Pasuria mund të rikthehet në koston e tij historike të zhvlerësuar, pra në vlerën kontabël më 31 dhjetor 2024, sikur nuk ka pasur kurrë një humbje nga dëmtimi më parë.

	€
Kostoja e pasurive më 1 janar 2020	60,000
Zhvlerësimi historik deri më 31 dhjetor 2024 (5/10)	<u>(30,000)</u>
Shuma historike bartëse më 31 dhjetor 31 dhjetor 2024	30,000
Shuma bartëse me 31 dhjetor 2024	<u>20,000</u>
Anulim i humbjes nga dëmtimi	10,000

Anulimi i humbjes njihet duke rritur pasurinë me €10,000 (€30,000 - €20,000) dhe duke njohur një fitim prej €10,000 në fitim ose humbje. Duhet të theksohet se i gjithë dëmtimi fillestar prej €16,000 nuk mund të kthehet mbrapsht. Dëmtimi mund të kthehet mbrapsht vetëm deri në një shumë maksimale të koston historike të zhvlerësuar, bazuar në koston origjinale dhe jetëgjatësinë e dobishme të vlerësuar të pasurisë. Vini re se nuk ka kthim mbrapsht të humbjes nga dëmtimi i emrit të mirë.

3.

a) Informacioni i mëposhtëm u nxor nga pasqyrat financiare të grupit Coverdale sh.a për fundin e vitit financiar më 31 dhjetor 2024 për të përcaktuar fitimet e thjeshtë për aksion dhe fitimet e dobësuara për aksion të vitit:

Fitimi pas tatimit nga operacionet e vazhdueshme	€1,925,000
Fitimi i interesave jo-kontrolluese	€200,000
Akasionet e zakonshme, *150,000 të emetuara për	€2,300,000
*(Kjo shifër përfshin edhe 50,000 aksione të zakonshme të emetuara më 1 prill 2024 për para të gatshme.)	
500,000 aksione preferenciale jo-kumulative me 5%, emetuar për	€1,500,000
Çmimi mesatar i tregut për një aksion të zakonshëm gjatë vitit	€15

Informata shtesë:

- Coverdale sh.a hyri në një transaksion tregu më 1 qershor 2024 për të riblerë 12,000 aksione të zakonshme me vlerë të drejtë
- Me 1 janar 2024 Coverdale sh.a emetori 4,000 obligacione të konvertueshme me një vlerë emetimi prej €1,000 për obligacion me 20% interes. Çdo obligacion është i konvertueshëm në 10 aksione të zakonshme. Zotëruesit e 3,800 obligacioneve të konvertueshme i konvertuan obligacionet e tyre në aksione të zakonshme më 1 nëntor 2024
- Norma e tatimit është 30%.

Kërkohet:

Për grupin Coverdale sh.a për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024, llogaritni:

- Fitimet e thjeshta për aksion.** (4 pikë)
- Fitimet e dobësuara për aksion.** (6 pikë)

b) Cornell sh. a. ka një pasuri me një vlerë bartëse prej €10,000 dhe një bazë tatimore prej €5,000. Në qoftë se do të ishte shitur pasuria, do të zbatohet norma e tatimit prej 10%. Për të gjitha të ardhurat e tjera do të zbatohet norma e tatimit prej 20%.

Kërkohet:

Tregoni pasojat për tatimet e shtyra në qoftë se Cornell sh. a:

- E shet pasurinë pa e përdorur më tej** (3 pikë)
- Pret që duke e përdorur të realizojë vlerën e saj bartëse.** (3 pikë)

c) Kiedis sh.a, një ofrues i madh i të dhënave të tregut të aksioneve në Kosovë, ofron të dhëna të tregut të aksioneve për investitorët në tregjet kryesore në Evropë.

Më 1 janar 2024, Kiedis sh.a i shiti një klienti qasje në bazën e të dhënave të saj në kohë reale për tre (3) vjet me një çmim të faturuar prej €3.6 milionë. Klienti ka të drejtën e qasjes në bazën e të dhënave të Kiedis sh.a në çdo kohë, 24 orë në ditë, për të marrë të dhëna në kohë reale në lidhje me çmimet e aksioneve në tregjet evropiane.

Në të njëjtën datë, Kiedis sh.a i shiti një klienti tjetër për €800,000 qasje në të dhëna historike për 30 vjet për dy (2) vitet e ardhshme. Klienti ka të drejtën e qasjes në të dhënat, që përmbajnë informacion historik nga viti 1995-2024 (24 orë në ditë) dhe është gjithashtu i lirë të shkarkojë të dhënat dhe t'i ruajë ato pasi të ketë kaluar qasja dyvjeçare në sistemin e Kiedis sh.a-së.

Kërkohet:

Këshilloni se sa të ardhura do të njihte Kiedis sh.a për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024 për secilën prej dy kontratave. (4 pikë)

(Total: 20 pikë)

a)

i) Fitimet e thjeshta për aksion

Formula për llogaritjen e fitimeve bazë për aksion është si më poshtë:

$$\frac{\text{Fitimet (humbjet)neto të atribuara tek aksionarët e zakonshëm}}{\text{Numri mesatar i ponderuar i aksioneve të zakonshme të pashlyera gjatë periudhës}}$$

Së pari, duhet të përcaktojmë fitimin që u atribuohet aksionarëve të zakonshëm si më poshtë:

Fitimi pas tatimit nga operacionet e vazhdueshme	€1,925,000
Fitimi i interesave jo-kontrolluese	(€200,000)
Dividendat preferenciale (5% x 500,000)	<u>(€25,000)</u>
Fitimi që u atribuohet aksionarëve të zakonshëm të kompanisë mëmë	€1,700,000

Më pastaj, duhet të përcaktojmë numrin mesatar të ponderuar të aksioneve të zakonshme të emetuara gjatë periudhës si më poshtë:

		Aksionet e emetuara	Aksionet e riblera	Aksionet e pashlyera	Nr. i muajve	Mesatarja e ponderuar
2024						
1 janar	Saldo në fillim	100,000		100,000	3	25,000
1 prill	Emetuar për para	50,000		150,000	2	25,000
1 qershor	Riblerja		12,000	138,000	5	57,500
1 dhjetor	Konvertimi i obligacioneve	38,000		176,000	<u>2</u>	<u>29,333</u>
31 dhjetor	Saldo në fund	188,000	12,000	176,000	12	<u>136,833</u>

Numri mesatar i ponderuar i aksioneve jepet nga:

$$(100,000 \times 3/12) + (150,000 \times 2/12) + (138,000 \times 5/12) + (176,000 \times 2/12)$$

ose

$$(100,000 \times 12/12) + (50,000 \times 9/12) - (12,000 \times 7/12) + (38,000 \times 2/12) = 136,833$$

Në fund, fitimet e thjeshta për aksion për Coverdale sh.a për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024 tani mund të llogariten:

$$\frac{€1,700,000}{136,833} = €12.42$$

ii) Fitimet e dobësuar për aksion

Llogaritja për fitimet e dobësuar për aksion përdor numrin mesatar të ponderuar të aksioneve të zakonshme që do të emetoheshin duke supozuar se konvertimi ose emetimi i çdo aksioni të zakonshëm potencial të dobësuar ndodh gjatë vitit financiar. Për secilin grup aksionesh të zakonshme potencial të dobësuar, rritja e fitimeve që i atribuohet aksionarëve të zakonshëm duhet të merret në konsideratë së bashku me efektin e tyre të dobësuar. Në këtë shembull, vetëm obligacionet e konvertueshme duhet të merren në konsideratë nga Coverdale sh.a për vitin financiar që përfundon më 31 dhjetor 2024.

Numri i obligacioneve të konvertueshme të emetuara ishte 4,000. Megjithatë, vetëm 3,800 u konvertuan në aksione të zakonshme në bazë të raportit 1 për 10 në 38,000 aksione të zakonshme dy muaj para fundit të vitit. Efekti i këtyre obligacioneve të konvertuara do të testohej për dobësim gjatë periudhës kur ato mbetën të pakonvertuara (domethënë, dhjetë muajt e parë). Ndërkohë, 200 obligacionet e pakonvertuara do të testoheshin për dobësim për të gjithë vitin. Testi për dobësim do të bazohej në interesin e kursyer pas tatimit dhe aksionet shtesë që do të emetoheshin pas konvertimit të supozuar të obligacioneve..

Përcaktoni fitimet shtesë për aksion të obligacioneve të konvertueshme për të treguar nëse është dobësuese (mund të zvogëlojë FPA e thjeshtë bazë ose të rrisë humbjen e thjeshtë për aksion) apo anti-dobësues.

	Rritja në fitimet	Rritja në numër	FPA shtesë	Koment
Obligacionet e konvertueshme				
<i>Interesi pas taksave i kursyer pas konvertimit të supozuar</i>	€471,333	33,667	€14.00	Anti dobësues
$10/12 \times 20\% \times 3,800 \times €1,000 \times 70\% + (20\% \times 200 \times €1,000 \times 70\%)$				

Konfirmim

	Fitimet	Numri	FPA shtesë	
FPA e thjeshtë	€1,700,000	136,833	€12.42	
Interesi i kursyer	<u>€471,333</u>	<u>33,667</u>		
	€2,171,333	170,500	€12.74	Anti dobësues

Obligacionet e konvertueshme përcaktohen të jenë anti- dobësues e pasi ato kanë efektin e rritjes së fitimeve të dobësuar për aksion nga €12.42 në €12.74.

Prandaj, ato nuk përfshihen dhe FPA e dobësuar llogaritet të jetë e njëjtë me FPA e thjeshtë bazë. Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024, fitimet për aksion për Coverdale sh.a do të shpalosen në shënimet e pasqyrave financiare si më poshtë.

FPA e thjeshtë
€12.42

FPA e dobësuar
€12.42

b)

(i) Njihet një detyrim i tatimit të shtyrë për $\text{€}(10,000 - 5,000) \times 10 \% = \text{€}500$.

(ii) Njihet një detyrim i tatimit të shtyrë për $\text{€}(10,000 - 5,000) \times 20 \% = \text{€}1,000$.

c)

Rasti do të trajtohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me konsumatorët*.

SNRF 15 kërkon që entitetet të zbatojnë një model me pesë hapa për të njohur të ardhurat në një mënyrë që përshkruan transferimin e mallrave ose shërbimeve të premtuara te konsumatori në një shumë që pasqyron shpërblimin për të cilin entiteti pret të ketë të drejtë në këmbim të atyre mallrave ose shërbimeve. Më konkretisht për skenarin, është e rëndësishme të përcaktohet se kur qasja e premtuar në të dhëna do të transferohet te konsumatorët, pasi kjo tregon se kur një detyrim performance përmbushet duke transferuar një mall ose shërbim të premtuar te një konsumator (që është kur konsumatori merr kontrollin e atij malli ose shërbimi). Një detyrim performance mund të përmbushet në një moment në kohë (zakonisht për premtimet për të transferuar mallra te një konsumator) ose me kalimin e kohës (zakonisht për premtimet për të transferuar shërbime te një konsumator).

Në situatën e parë, ku Kiedis sh.a. shiti qasje në një bazë të dhënash në kohë reale, Kiedis sh.a. i ka dhënë të drejtën për të qasur pronën e saj intelektuale siç ekziston në kohën e qasjes. Për më tepër, përmbajtja e asaj prone intelektuale përditësohet vazhdimisht. Kjo i lejon klientit të marrë dhe të konsumojë njëkohësisht përfitime nga përmbushja e detyrimit nga Kiedis sh.a.

Prandaj, Kiedis sh.a njuh të ardhurat nga ajo kontratë me kalimin e kohës; d.m.th. €1.2 milion (d.m.th. €3.6 milion pjesëtuar me 3 vjet). Pjesa e mbetur prej €2.4 milion do të paraqitet gjysma si detyrim afatshkurtë dhe gjysma detyrim afatgjatë.

Në situatën e dytë, ku Kiedis sh.a shiti të dhëna historike, ajo i ofroi klientit pronësi intelektuale që nga një moment në kohë. Në këtë rast, qasja me kalimin e kohës nuk duket të jetë një aspekt kyç i detyrimit të performancës dhe detyrimi i performancës i Kiedis sh.a përmbushet në kohën e shitjes. Kështu, Kiedis sh.a njuh €800,000 të ardhura në kohën e shitjes (1 janar 2024).

4.

(a) Më 1 janar 2024, Plant sh.a i dha secilit prej ekipit të saj të lartë të menaxhimit ose 260,000 aksione në Plant sh.a ose një ekuivalent në para të barabarta me çmimin e tregut të 240,000 aksioneve. E drejta është e kushtëzuar nga qëndrimi i menaxherëve në punë në Plant sh.a deri më 31 dhjetor 2025. Plant sh.a rezervon të drejtën për të zgjedhur nëse do ta shlyejë skemën me para të gatshme ose me aksione. Megjithatë, në të kaluarën, Plant sh.a gjithmonë ka zgjedhur të shlyejë skema të ngjashme me para të gatshme. Nëse aksionet emetohen, ato duhet të mbahen për dy (2) vjet pas 31 dhjetor 2025 para se të shiten.

Çmimi për aksion i Plant sh.a ishte €3,400 më 1 janar 2024 dhe €3,600 më 31 dhjetor 2024. Ai u rrit në €3,700 më 20 janar 2025, datë kur pasqyrat financiare u autorizuan për publikim. Vlera e drejtë e alternativës së aksioneve u llogarit në €3,240, €3,440 dhe €3,540 përkatësisht në të njëjtat data. Më 1 janar 2024, ekipi i menaxhmentit të lartë kishte 120 anëtarë. Më 1 janar 2024, nuk pritej që asnjë anëtar i ekipit të largohej gjatë periudhës së përfitimit. Megjithatë, për shkak të një tregu punë të mirë, tetë (8) menaxherë u larguan në dhjetor 2024 dhe më 31 dhjetor 2024, dymbëdhjetë (12) menaxherë të tjerë pritej të largoheshin brenda pak muajsh pas përfundimit të vitit.

Kërkohet:

Shpjegoni trajtimin e duhur kontabël të transaksionit të mësipërm të Plant sh.a për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024. (7 pikë)

b) Më 1 janar 2024, Halford sh.a emetoi 10,000 obligacione me një vlerë nominale prej €100 secila me një çmim tregu prej €95. Ndërmjetësit e obligacioneve ngarkuan tarifa që arrinin në total €18,000 në lidhje me emetimin e obligacioneve. Obligacionet kanë një normë kuponi prej 5% dhe janë të ripagueshme (maturojnë) pas tre (3) viteve me vlerën nominale. Obligacionet kanë një normë fillestare efektive interesi prej 7.62%. Pagesat e kuponave duhet të bëhen më 31 dhjetor të çdo viti gjatë afatit të maturimit të obligacioneve.

Në përcaktimin e trajtimit të duhur kontabël të obligacioneve, Halford sh.a ka arritur në përfundimin se obligacionet janë një detyrim jo-derivativ dhe se opsioni i vlerës së drejtë nuk duhet të zbatohet. Kjo është në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet Financiare*. Megjithatë, kishte disa konfuzione se si duhet të kontabilizohen obligacionet. Aktualisht, paratë e marra nga emetimi i obligacioneve neto nga tarifat e ndërmjetësit janë njohur si një detyrim afatgjatë. Pagesa e parë e kuponit më 31 dhjetor 2024 është njohur si shpenzim (e përfshirë në kostot e financimit) në arritjen e fitimit para tatimit.

Kërkohet:

Shpjegoni se si duhet të kontabilizohen obligacionet në pasqyrat financiare të Halford sh.a për vitin më 31 dhjetor 2024, duke përfshirë çdo korigjim në draft pasqyrat financiare. (7 pikë)

c) Tyler sh.a është një kompani telekomunikacioni me fundvit më 31 dhjetor 2024 që operon një skemë pensioni me përfitime të përcaktuara. Më 30 qershor 2024, kompania njoftoi se do të mbyllte një degë biznesi dhe ra dakord t'i paguante secilit prej 300 punonjësve të saj një pagesë në para prej €100,000 për t'i kompensuar ata për humbjen e pensionit që rrjedh nga inflacioni i pagave. Është vlerësuar se mbyllja do të zvogëlojë vlerën e tanishme të detyrimit të pensionit me €11.6 milionë. Tyler sh.a nuk është e sigurt se si të trajtoj pagesën dhe zvogëlimin dhe ende nuk e ka regjistruar transaksionin në pasqyrat e saj financiare.

Kërkohe:

Në përputhje me SNK 19 *Përfitimet e Punonjësve*, tregoni trajtimin kontabël për transaksionin e mësipërm në pasqyrën financiare të Tyler sh.a për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024.

(6 pikë)

4.

(a) Ky është një transaksion pagese me aksione ku Plant sh.a ka një zgjedhje të shlyerjes. SNRF 2 Pagesat e bazuara në aksione kërkon që transaksioni të trajtohet si i shlyer me para të gatshme nëse ekziston një detyrim aktual për t'u shlyer me para në dorë. Nëse nuk ka detyrim, transaksioni duhet të trajtohet si i shlyer me me ekuitet. Këtu, praktika e kaluar e Plant sh.a për të shlyer gjithmonë me para të gatshme ka krijuar një pritje të vlefshme tek punonjësit se ata do të marrin para të gatshme. Prandaj, ekziston një detyrim aktual konstruktiv për Plant sh.a për të shlyer me para të gatshme dhe Plant sh.a duhet ta kontabilizojë skemën si një transaksion të shlyer me para të gatshme.

Pagesat e bazuara në aksione të shlyera me para të gatshme kontabilizohen si më poshtë:

- Një shpenzim duhet të njihet gjatë periudhës së përfutimit të titullit (2 vjet)
- Një detyrim përkatës duhet të regjistrohet në pasqyrën e pozitës financiare
- Detyrimi duhet të matet me vlerën e drejtë dhe kjo vlerë e drejtë të përditësohet çdo fund viti për të dhënë vlerësimin më të mirë të shumës që do të paguhet
- Çdo largim i pritur gjatë periudhës së përfutimit të titullit duhet të hiqet nga numri i punonjësve pasi ata nuk do të marrin pagesën e bazuar në aksione (duhet të përdoret vlerësimi më i mirë në çdo fund viti).

Llogaritja

Vlera e drejtë e detyrimit në fund të vitit vlerësohet duke përdorur çmimin e aksionit në fund të vitit pasi ky përfaqëson vlerën e parave në atë datë.

Detyrimi më 31 dhjetor 2024 dhe shpenzimi përkatës që do të njihet në fitim ose humbje për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024 llogaritet si më poshtë:

Nr. i punonjësve të vlerësuar në fund të vitit që do të kenë të drejtën e ushtrimit në datën e përfutimit të titullit (120 menaxherë – 8 të larguar -12 që pritet të largohen) x Numri i secilës të drejtë (240,000 aksione) x vlerë e drejtë e secilës të drejtë në fund të vitit (€3,600) x Pjesa proporcionale kumulative e periudhës së përfutimit të titullit që ka kaluar ($\frac{1}{2}$ e aksioneve të fituara) = €43,200,000,000.

(b)

Sipas modelit të kostos së amortizuar të IFRS 9, detyrimet financiare duhet të njihen fillimisht me vlerën e drejtë duke përfshirë kostot e transaksionit. Prandaj, në njohjen fillestare obligacionet duhet të maten me:

	€
Vlera e drejtë e shumës së marrë	950,000
Minus: kostot e transaksionit	<u>(18,000)</u>
Shuma bartëse	932,000

Njohja dhe matja fillestare e detyrimeve financiare është kryer në mënyrë korrekte në pasqyrat financiare të Halford sh.a.

Hyrjet në ditari janë

Debi	Paraja	932,000	
Kredi	Detyrimi financiar		932,000

Më pas, obligacionet duhet të maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit si më poshtë::

Shuma bartëse me 1 janar 2024	932,000
Kosto financiare e ngarkuar në F/H për vitin 2024 (7.32% x 932,000)	68,222
Minusa paraja e paguar 5% x €10,000 x 100	<u>(50,000)</u>
Shuma bartëse raportuar në PPF me 31 dhjetor 2024	950,222

c) Pagesa e vlerësuar e detyrimit të pensionit është €30 milionë (300 x €100,000) dhe duhet të përfshihet brenda detyrimeve afatshkurta në pasqyrën e pozitës financiare. Meqenëse kjo është €18.4 milionë më shumë se fitimet e vlerësuara nga zvogëlimi prej €11.6 milionë, një humbje prej €18.4 milionë duhet të përfshihet brenda fitimeve të mbajtura. Detyrimet afatgjata zvogëlohen me uljen e detyrimeve të pensionit prej €11.6 milionë.

5. Partneri Menaxhues ju ka kërkuar, në emër të aksionarëve, të përgatitni një raport mbi pozitën financiare dhe biznesore të Hetfield sh.a, një entitet i listuar në bursë. Ka pasur komente negative në shtyp mbi "menaxhimin agresiv të fitimeve" nga Hetfield sh.a dhe kritika ndaj menaxhmentit. Informacioni rreth Hetfield sh.a është mbledhur nga partneri dhe është paraqitur më poshtë:

Hetfield sh.a ofron shërbime të hostimit elektronik, shpërndarjes dhe marketingut të bazuara në internet. Hetfield sh.a u formua në vitin 2021 me Bordin që premtoi ta fusë kompaninë në 15% të kompanive më të mira të listuara brenda pesë (5) viteve. Menaxhmenti është shumë i motivuar dhe kompensohet pjesërisht përmes opsioneve të aksioneve. Menaxhmenti punon në një mjedis nën presion. Hetfield sh.a përdor entitete të ndryshme të korporatave për të financuar biznesin e tij. Hetfield sh.a ka marrë hua €40 milionë nga njëzet Mikro Financa të ndryshme të cilat janë në pronësi të një banke, e cila vetë zotëron njëzet e pesë përqind (25%) të aksioneve të Hetfield sh.a. Hetfield sh.a ka depozituar €35 milionë te Mikro Financat, me bilancin neto që tregohet si një detyrim afatshkurtë. Menaxhmenti i Hetfield sh.a thotë se Mikro Financat nuk janë nën kontrollin e tyre dhe se për shkak se çdo shumë e marrë hua është individualisht jo-materiale, nuk ka nevojë të shpaloset marrëdhënia në pasqyrat financiare.

Për më tepër, duket se në vitet e mëparshme një praktikë e zakonshme ishte që Hetfield sh.a të faturonte të njëjtat Mikrofinanca në javën e fundit të vitit financiar për shërbime dhe t'i anulonte faturat pasi Hetfield sh.a të kishte publikuar pasqyrat e saj financiare.

Informacioni i pasqyrave financiare i nxjerrë nga pasqyrat e publikuara për vitet që përfunduan më 31 dhjetor 2024 dhe 2023.

Ekstrakte nga pasqyra e pozitës financiare

	2024 €' milion	2023 €' milion
<i>Pasuritë</i>		
Pasuritë jo-qarkulluese:		
Prona	10	8
Impiantet dhe paisjet	40	30
Pasuritë e paprekshme	<u>20</u>	<u>12</u>
	70	50
Pasuritë qarkulluese	<u>230</u>	<u>240</u>
Total pasuritë	300	290
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>		
Ekuiteti:		
Kapitali aksionar – €1 aksione të zakonshme	30	30
Rezerva – Rezerva e rivlerësimit	30	20
Rezerva – Fitimet e mbajtura	<u>10</u>	<u>60</u>
Total ekuiteti	70	110
Detyrimet:		
Detyrimet afatgjata	50	40
Detyrimet afatshkurta	<u>180</u>	<u>140</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	300	290

Ekstrakte nga pasqyra e fitimit ose humbjes

	2024 € milion	2023 € milion
Të hyrat	160	200
Fitimi para interesit dhe tatimit	30	95
Fitimi/(humbja) para tatimit	(10)	40

Informata tjera:

- | i) | 2024 | 2023 |
|---|------|------|
| Numri i punonjësve | 150 | 250 |
| Numri i ditëve pas fundit të vitit
deri në publikimin e pasqyrave financiare | 65 | 25 |
- ii) Pasuritë jo-qarkulluese janë rivlerësuar nga njëri prej Drejtorëve të Hetfield sh.a, i cili nuk ka kualifikim profesional të njohur dhe ka përdorur vlerën e realizueshme të vlerësuar si bazë të vlerësimit. Impiantet dhe pajisjet janë të një natyre shumë të specializuar dhe janë ndërtuar nga vetë Hetfield sh.a dhe janë kryesisht pajisje kompjuterike. Pasuritë e paprekshme janë kostot e blerjes së të dhënave dhe kapjes së të dhënave (data capture) të bazave të të dhënave të zhvilluara brenda kompanisë dhe kapitalizohen si shpenzime zhvillimi dhe shlyhen gjatë katër (4) viteve.
- iii) Në vitin deri më 31 dhjetor 2023, një obligacion gjashtë (6) vjeçar u emetua nga Hetfield sh.a me një vlerë nominale prej €40 milionë për €42 milionë. Teprica mbi vlerën nominale u njoh në fitim ose humbje. Në vitin deri më 31 dhjetor 2024, një obligacion tjetër gjashtë (6) vjeçar me një vlerë nominale prej €10 milionë u emetua për €11 milionë dhe u kontabilizua në të njëjtën mënyrë. Investitorët mund të kërkojnë ripagim të obligacionit pas tre (3) vitesh ose nëse koeficienti qarkullues bie nën 1.3. Obligacionet kanë interes prej 5% në vit dhe janë të ripagueshme me vlerën nominale.
- iv) Të ardhurat përfaqësojnë shumën e faturuar të mallrave të shitura dhe shërbimeve të ofruara dhe punës së kryer gjatë vitit sipas kontratave.
- v) Hetfield sh.a ka publikuar pasqyrat financiare të ndërmjetme për katër muajt deri më 31 prill 2025, të cilat tregojnë fitimin para tatimit në €20 milionë, detyrimet afatgjata të reduktuara në €10 milionë dhe koeficientin qarkullues në 1.5.

Kërkohet:

Përgatitni një raport për partnerin menaxhues mbi pozitën financiare dhe biznesore të Hetfield sh.a, duke marrë për bazë implikimet e informacionit financiar dhe informacionit tjetër të përshkruar më sipër. (20 pikë)

5.

Raport mbi pozitën financiare dhe biznesore të Hetfield sh.a

Për: Aksionarët

Nga: Kontabilisti i certifikuar

Data: 27 shtator 2025

Tema: Implikimet e informacionit financiar dhe informacionit tjetër që lidhet me mjedisin e biznesit dhe financiar të Hetfield sh.a

Menaxhmenti i Hetfield sh.a punon në një mjedis me presion. Bordi ka premtuar ta fusë Hetfield sh.a në 15% të kompanive më të mira brenda pesë viteve dhe kështu menaxhmenti do të jetë nën presion për të arritur këtë qëllim. Menaxhmenti do të jetë i shtyrë fort për të përmbushur ato që mund të shihen si objektiva tepër optimiste. Përveç kësaj, ekzistojnë marrëveshje borxhi të lidhura me koeficientët financiar (mbajtësit e obligacioneve mund të kërkojnë ripagimin nëse koeficienti qarkullues bie nën 1.3) dhe me kompensimin e tyre të lidhur pjesërisht me këto opsione aksionesh dhe rrjedhimisht me performancën, menaxhmenti mund ta vërë nën presion të gjithë stafin. Ky mjedis mund të krijojë një nxitje për të miratuar praktika kontabël që përmbushin pritjet e drejtorëve dhe tregjeve të kapitalit, ose për të shkuar përtej praktikave normalisht të pranueshme të kontabilitetit. Shembuj të mundshëm të kësaj janë paraqitur në diskutimin e mëposhtëm:

- Hetfield sh.a i përdor Mikro Financat si mjete për qëllime të veçanta (SPV)/entitete për qëllime të veçanta (SPE). Transaksionet me SPV/SPE shpesh synojnë të zhvendosin pasuritë/detyrimet nga pasqyra e pozitës financiare dhe kërkojnë vëmendje të veçantë për shkak të rregullave shpesh komplekse të kontabilitetit dhe shpalosjeve që zbatohen. Hetfield sh.a ka marrë hua €40 milionë nga njëzet Mikro Financa të ndryshme dhe ka depozituar shumicën e huamarrjeve tek këto Mikro Financa në mënyrë që vetëm shuma neto prej €5 milionë të shfaqet në pasqyrat financiare. Përdorimi i transaksioneve të tilla përbën një rrezik potencial për një investitor në Hetfield sh.a pasi ka çështje në lidhje me arsyet pse menaxhmenti përdor mjete të tilla dhe natyrën e trajtimit kontabël të këtyre transaksioneve. Në këtë rast mund të argumentohet se Mikro Financat janë degë të Hetfield sh.a dhe jo degë të bankës, në të cilin rast netimi i pasurive dhe detyrimeve bruto mund të arrihet përmes një korigjimi të konsolidimit. Marrëveshjet duhet të shqyrtohen me kujdes pasi është e rëndësishme të përcaktohet nëse ato janë degë të Hetfield sh.a apo të bankës.
- Do të duhet të bëhet referencë për SNRF 3 *Kombinimet në biznes dhe Kornizës Konceptuale*. Do të duhet të përcaktohet nëse banka është e ekspozuar ndaj humbjes së mundshme prej €5 milionë (€40 milionë - €35 milionë), duke treguar se është pronari ekonomik, si dhe ai ligjor i entiteteve të financimit. Prandaj, ekziston mundësia që €35 milionë kredi shtesë të paraqiten në pasqyrën e pozitës financiare të Hetfield sh.a, nëse banka është në fakt pronare e Mikrofinancave dhe nëse transaksioni nuk i plotëson kriteret për netim në SNK 32 *Instrumentet Financiare: Paraqitja*.
- Gjithashtu, banka zotëron 25% të aksioneve të Hetfield sh.a dhe mund të konsiderohet si një "palë e lidhur" sipas SNK 24 *Shpalosjet e palëve të lidhura*. Kjo rrit rrezikun e kontabilitetit të papërshtatshëm dhe mundësinë që përmbajtja ekonomike e transaksionit të jetë e ndryshme nga forma e saj ligjore, ose që transaksioneve t'u

mungojë përmbajtja. Për më tepër, pohimi i menaxhmentit se çdo transaksion individual me Mikrofinancat është i parëndësishëm nuk është i vlefshëm. Transaksionet e kësaj natyre duhet të shihen kolektivisht dhe jo individualisht.

- Duket se këto Mikrofinanca janë përdorur edhe për të rritur fitimet, pasi faturat u janë lëshuar atyre para fundit të vitit, të cilat më pas janë anuluar pasi Hetfield sh.a ka publikuar pasqyrat e saj financiare. Menaxhmenti i Hetfield sh.a duket se po përdor praktika të dyshimta për të manipuluar shifrat në pasqyrat financiare.
- Prona, impiantet dhe pajisjet janë vlerësuar nga një prej drejtorëve të Hetfield sh.a. SNK 16 *Prona, impiantet dhe pajisjet* jep udhëzime se kush duhet të kryejë vlerësimet duke thënë se vlera duhet të përcaktohet nga 'vlerësimi që normalisht kryhet nga vlerësues të kualifikuar profesionalisht' dhe drejtori nuk është një vlerësues i kualifikuar. Ky fakt vë në dyshim vlerat e paraqitura të pronës, impianteve dhe pajisjeve. Impianti dhe pajisjet janë të një natyre të specializuar dhe për këtë arsye janë të vështira për t'u vlerësuar, veçanërisht pasi janë ndërtuar nga vetë Hetfield sh.a. Mund të argumentohet se drejtori është ndoshta personi më i mirë për të vlerësuar pasuri të tilla. Megjithatë, mungesa e pavarësisë në proces dhe mungesa e pajtueshmërisë me SNK 16 rrit rrezikun e mbështetjes në shifrat për pronën, impiantet dhe pajisjet. Përveç kësaj, SNK 16 thotë se vlera e drejtë e tokës dhe ndërtesave dhe impiantit dhe pajisjeve është zakonisht vlera e tregut, jo një vlerësim i vlerës së realizueshme. Për më tepër, kur nuk ka prova të vlerës së tregut për impiantet dhe pajisjet për shkak të natyrës së tyre të specializuar (siç është rasti në këtë rast), atëherë ato mund të duhet të vlerësohen me koston e amortizuar të zëvendësimit.
- Pasuritë përveç pronave vlerësohen lehtësisht dhe për këtë arsye ka dyshime për arsyet themelore të vlerësimit të impianteve dhe pajisjeve dhe vërtetësinë e shifrave për pronën, impiantet dhe pajisjet. Rezerva e rivlerësimit është rritur me €10 milionë gjatë vitit.
- SNK 38 *Pasuritë e paprekshme* përcakton kriteret që duhet të përmbushen për të njohur një pasuri të paprekshme të gjeneruar nga brenda. Sa i përket kostove të zhvillimit, Hetfield sh.a kërkohet të tregojë se pasuria e paprekshme do të gjenerojë rrjedha hyrëse neto parash që tejkalojnë rrjedhat dalëse të parave dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Gjithashtu, kostot e zhvillimit të njohura si një pasuri i nënshtrohen një testi dëmtimi sipas SNK 36 *Dëmtimi i pasurive*. Kriteret për të njohur këto kosto të përdorura nga Hetfield sh.a do të duhet të shqyrtohen, por në shikim të parë duket se këto kosto duhet të ishin shlyer.
- Hetfield sh.a ka të ngjarë të jetë i ndryshëm ndaj ndryshimeve negative në kushtet ekonomike dhe kështu mund të zhvillohet shpejt një krizë likuiditeti. 'Obligacioni i investitorit' mund të duket se është kontabilizuar gabimisht sipas SNRF 9 *Instrumentet Financiare*, i cili kërkon që instrumente të tilla të kontabilizohen me koston e amortizuar. Hetfield sh.a duhet të njohë kreditim financiar (€2 milionë në vitin 2022, €1 milionë në vitin 2023) gjatë periudhës më të shkurtër që investitori mund të kërkojë ripagim, e cila në shikim të parë duket se është tre vjet, por meqenëse investitorët mund të kërkojnë ripagim nëse koeficienti qarkullues bie nën 1.3, mund të

argumentohet se trajtimi aktual kontabël është i saktë. Instrumente të tilla financiare nuk përshtaten lehtësisht me SNRF 9 *Instrumentet Financiare*, gjë që mund të jetë arsyeja pse menaxhmenti zgjodhi këtë formë instrumenti. Në përgjithësi, obligacioni duhet të njihet me shumën që do të paguhej nëse mbajtësi i obligacionit do të ushtronte të drejtën e tij. Aktualisht, koeficienti qarkullues është $230 \div 180$, d.m.th. 1.28, që do të thotë se kushti i borxhit nuk është përmbushur. Hetfield sh.a mund të vihet nën presion për të ripaguar obligacionet.

- Ka trende negative që ndikojnë në qëndrueshmërinë e Hetfield sh.a. Këto përfshijnë transaksionet jashtë pasqyrës së pozitës financiare, humbjet operative, përkeqësimin e likuiditetit, mospagesat e mundshme të kredive (obligacioneve) dhe rritjen e varësisë nga financimi i jashtëm, siç dëshmohet nga rritja e detyrimeve afatgjata dhe e levës financiare. Këta faktorë rreziku duhet të vlerësohen në dritën e çdo plani menaxhimi për të zbutur gjendjen dhe ngjarjet ekzistuese. Këto trende dëshmohen në koeficientë të llogaritura në shtojcë.
- Të ardhurat njihen sipas faturimit, por kur ato faturohen mbetet një mister. Ky lëshim thelbësor heq çdo vlerë reale nga informacioni pasi ata mund të faturojnë para se të kryhen shërbimet. Në mënyrë të ngjashme, politika e përdorur për punën e ndërmarrë në kontrata është e paqartë.
- Përdorimi i informacionit të ndërmjetëm është i mbushur me vështirësi. Informacioni i ndërmjetëm mund t'i mashtrtojë investitorët nëse errëson rezultatet e vërteta të SNRF-ve. Një informacion i tillë nuk hartohet gjithmonë në përputhje me SNRF-të dhe nëse nuk ka pajtim me SNRF-të, informacioni duhet të shihet me skepticizëm. Hetfield sh.a mund të jetë duke përdorur pasqyrat financiare të ndërmjetme për të ndryshuar imazhin e tyre me humbje dhe probleme me borxhin në një me fitim të shëndetshëm pa probleme me borxhin. Mund të ketë patur mungesë informacioni të rëndësishëm dhe pa shpallje të qarta dhe të kuptueshme për çdo mungesë, pasqyrat e ndërmjetme janë të pakuptimta.

Konkluzion

Ka shumë probleme dhe çështje të mundshme që duhen zgjidhur. Shifrat e raportuara në pasqyrat financiare të ndërmjetme tregojnë një kthesë të jashtëzakonshme në pozitën financiare të Hetfield sh.a dhe si të tilla duhet të shihen me një shkallë të lartë skepticizmi. Ka pasur një ulje dramatike (250 në vitin 2023 në 150 në vitin 2024) të numrit të punonjësve që mund të kenë implikime në kontrollin e brendshëm dhe vonesa e publikimit në lidhje me pasqyrat financiare është rritur (65 ditë në vitin 2024 nga 25 ditë në vitin 2023) në mënyrë dramatike me përfundimin se ka pasur probleme në finalizimin e këtyre pasqyrave. Duket se ka një përpjekje nga drejtorët për të përmirësuar performancën e Hetfield sh.a dhe ka çështje kulturore biznesi në lidhje me menaxhimin e Hetfield sh.a që duhen adresuar. Hetfield sh.a është potencialisht i paafët të paguajë pasi ka €35 milionë kredi që nuk janë regjistruar në pasqyrën e pozitës financiare dhe mbajtësit e obligacioneve pothuajse me siguri do të kërkojnë shlyerjen e kredive të tyre brenda një afati të shkurtër. Koeficienti qarkullues po përkeqësohet.

Koeficienti i hyrjes në borxh është rritur pa marrë parasysh kreditë që nuk janë njohur në pasqyrën e pozitës financiare dhe shifrat për të ardhurat, pronën, impiantet dhe pajisjet dhe

stoqet janë të gjitha potencialisht të pasakta. Së fundmi, drejtorët kanë publikuar pasqyrat financiare të ndërmjetme në një përpjekje për të rritur besimin në Hetfield sh.a. Duke pasur parasysh natyrën e problemeve të përshkruara më sipër dhe mospërputhjen e informacionit të ndërmjetëm me pritjet, do të ishte e vështirë të rekomandohej ndonjë formë investimi në Hetfield sh.a.



Kontabilisti

Shtojca

	2024	2023
Koeficienti qarkullues 2024, 230/180; 2023, 240/140	1.28	1.71
Hyrja në borxh		
Detyrimet afatgjata / (Ekuitet + Detyrimet afatgjata)		
2024 = 50 / (70+50) ; 2023 = 40 / (110+40)	0.42	0.27